



Arrestohen dy të dyshuar në Podujevë, dyshohen për trafikim me armë

KRONIKA | October 13, 2022 - 16:34

SHPËRNDAJE: [f](#) [t](#)

Zyrtarë policorë nga Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar, në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit, duke u bazuar në urdhëresën e gjykatës kompetente, ka hartuar dhe ka zbatuar një plan operativ.

Sipas njoftimit thuhet se gjatë ditës së sotme në rajonin e Podujevës, kanë arrestuar dy persona të dyshuar për trafikim me armë.

“Arrestimi i tyre është bërë gjatë një plani operativ të hartuar nga zyrtarët policorë të Njesisë për Hetimin e Krimit të Organizuar, në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit, duke u bazuar në urdhëresën e gjykatës kompetente”, thuhet në njoftim.

“Njësitë policore nga Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar në këto lokacione, kanë kryer kontrole të shtëpive dhe objekteve përcjellëse, pronë e të dyshuarve me qëllim të mbledhjes së provave për veprimtarinë kriminale të të dyshuarve. Në asistencë të realizimit të këtij plani operativ kanë marrë pjesë edhe Njësia Speciale Operative dhe K9 (Njësia me qen)”, thuhet në njoftimin e policisë.









Gjatë këtij operacioni policor janë sekuestruar këto prova materiale: tri armë (dy AK47, një revole), 219 fishekë kalibra të ndryshëm dhe pjesë për armë të kalibrave të ndryshëm, një maskë dhe dy telefona mobilë.

Ndaj të dyshuarve inicohet rasti nën dyshimin e përfshirjes në dy vepra penale: ‘Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse’ dhe ‘Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve’.





Pas intervistimit, me aktvendim të prokurorit dy të dyshuarit dërgohen në mbajtje për 48 orë. /Zëri



Të rekomanduara

 Mitrovicasit ia vjedhin dhe djegin Golf 2-shin October 13, 2022	 Mashtruan një person me kriptovaluta, arrestohen një femër dhe një mashkull në Prishtinë October 13, 2022
 Pejani sulmon me thikë e sëpatë anëtarët e familjes së tij KRONIKA October 13, 2022	 Traktori mbyt një person në Junik KRONIKA October 13, 2022
 Gjendet i vdekur një person afër një fabrike në Viti KRONIKA October 13, 2022	 Sherr me thika në Itali, vdes 45-vjeçari kosovar KRONIKA October 13, 2022
 Vriten babë e bir në Shqipëri KRONIKA October 12, 2022	 Aksident tragjik në Itali, humb jetën 20-vjeçari shqiptar KRONIKA October 12, 2022

Më të lexuarat

 U rrokullis me traktor në bjeshkë, vdes i riu nga Juniku KRONIKA October 12, 2022	 Vriten babë e bir në Shqipëri KRONIKA October 12, 2022
 Gjendet i vdekur një person afër një fabrike në Viti KRONIKA October 13, 2022	 Sherr me thika në Itali, vdes 45-vjeçari kosovar KRONIKA October 13, 2022
 Aksident tragjik në Itali, humb jetën 20-vjeçari shqiptar KRONIKA October 13, 2022	 Traktori mbyt një person në Junik KRONIKA October 13, 2022